



BASHKIA
TIRANË

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt. 12.01.2023]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(PARAPRAK)

OPERATORIT EKONOMIK “PC STORE” SHPK

Adresa: Tirane Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Blerje pajisje elektronike për nevoja të Klubit Sportiv Studenti”** me Nr. REF: 55153-12-27-2022 për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 179 datë 30 Dhjetor 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **Operatori ekonomik “PC STORE” shpk me NUIS L01606034A**

Vlera e ofertës pa tvsh = 981.000 (nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë.

- **Operatori ekonomik “Smart Technologies Albania” shpk me NUIS L61425009V**

Vlera e ofertës pa tvsh = 932.420 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e njëzet) lekë.

Nga pjesërmarrësit është s'kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “Smart Technologies Albania” shpk me NUIS L61425009V**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Smart Technologies Albania” shpk nga ku rezultoi si vijon:

Operatori Ekonomik “Smart Technologies Albania” sh.p.k, nuk përmbush asnjë prej kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat standarde të tenderit, për këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi pasi nuk ka paraqitur oferte teknike financiare edhe ligjore ka paraqitur vetem formularin e ofertes ekonomike shtojca 1 dhe shtojca 2 dhe asnjë dokument tjetër.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**PC STORE**” **shpk**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 981.000 (nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.